

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/haga-denoi-kosoven-tensione-dhe-perplasje-jashte-gjykates-speciale--i514421
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:33:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6ef73a49d4a56ad4050fb434ec144824a72161f470f29905cf13e830da0c91de
TEKSTI	c90593ef29fdb84edd3f0a8015dd1a9a01e915c8e11e83025ce1c8521a5328f4
PAMJA	c7358b5a2d1ca8c04c4c4be6a3f16319d43fe324db92c996aa0764cc970d2244

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e540420b73805038d64d23da83d745350ced7f1453f6cc1b294b54a998da802
E MËPARSHMJA	d5c2ec1c87f38ed6f94d0a04cb856c7f71340e217fc041fd03be2e526ef6e5ba
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e540420b73805038d64d23da83d745350ced7f1453f6cc1b294b54a998da802>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

39 MINUTA ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

4 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

15 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

17 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

LIVE UPDATES

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

• Pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë kanë nisur reagimet e para nga figurat publike dhe familjarët e ish-krerëve të UÇK-së. • Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, janë dënuar me nga 25 vite burg, ndërsa Kadri Veseli me 18 vite dhe Rexhep Selimi me 13 vite. • Kryeministri Edi Rama e ka kundërshtuar dënimin me një reagim të shkurtër, duke shkruar "Marre". • Nga Partia Demokratike ka reaguar Gazement Bardhi, duke e quajtur këtë vendim si të papranueshëm. • Në Kosovë, Glauk Konjufca e ka cilësuar aktgjykimin si të padrejtë dhe të pamerituar, ndërsa Enver Hoxhaj e ka përshkruar këtë ditë si "ditën më të zezë" për popullin shqiptar. • Edhe Hysni Gucati e ka quajtur vendimin të papranueshëm, duke deklaruar se me të "u kënaqën Serbia dhe Rusia". • Nga familja e Hashim Thaçit është bërë e ditur se do të vijojë beteja në Apel, ndërsa familjarët e Jakup Krasniqit kanë shprehur kundërshtimin ndaj vendimit. • Ndërkohë, në Prishtinë dhe në Hagë janë zhvilluar tubime nga mbështetës të katër ish-krerëve të UÇK-së, të cilët kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës.

17 artikuj për këtë temë.

2 MINUTA ME PARE

Avokati i Thaçit paralajmëron apelimin e vendimit: Ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare



Pierre-Richard Prosper

HAGË- Avokati i Hashim Thaçit, Pierre-Richard Prosper, e ka cilësuar aktgjykimin ndaj klientit të tij si një tallje me drejtësinë dhe ka paralajmëruar se mbrojtja do ta apelojë vendimin. Prosper pretendoi se rezultati i procesit ishte i paracaktuar dhe akuzoi Dhomat e Specializuara se po "rishkruejnë historinë", duke e paraqitur UÇK-në si një strukturë të organizuar dhe duke ia atribuar përgjegjësinë Thaçit.

"Kjo është një ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare dhe fundi i tribunaleve", tha Prosper pas shpalljes së aktgjykimimit.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Ai tha se ka biseduar me Taçin dhe se do ta takojë sërish.

"Thaçi është i gatshëm të vazhdojë të luftojë për veten dhe për popullin e Kosovës", tha Prosper.

Sipas tij, shpresa e mbrojtjes është që aktgjykimi të rrëzohet në apel, ndonëse paralajmëroi se procesi mund të zgjasë me vite. Prosper bëri thirrje, gjithashtu, që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë raportin me Dhomat e Specializuara, duke thënë se Kosova duhet të marrë "një vendim sovran që është në interesin më të mirë të vendit".

"Nëse do të isha deputet, që nga nesër do ta tërhiqja mbështetjen për këtë gjykatë", tha Prosper./Dosja.al

7 MINUTA ME PARE

Haga dënon Kosovën/ LDK: Asnjë aktgjykim nuk mund ta zhbëjë të vërtetën historike të luftës



LDK

KOSOVË- Lidhja Demokratike e Kosovës ka reaguar pas aktgjykimit të sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në një njoftim për media, LDK-ja ka thënë se e ka pritur me shqetësim shumë të thellë vendimin e sotëm, duke theksuar ndjeshmërinë e këtij momenti për qytetarët e Kosovës.

"Lidhja Demokratike e Kosovës e ka pritur me shqetësim shumë të thellë aktgjykimin e sotëm ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përmasën e dënimeve ndaj tyre. Të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e këtij momenti për qytetarët e vendit, bëjmë thirrje për qetësi, maturi dhe përgjegjësi", thuhet në reagim.

LDK-ja ka theksuar se liria dhe pavarësia e Kosovës janë rezultat i sakrificës së brezave, duke përmendur rezistencën politike e paqësore të udhëhequr nga presidenti Ibrahim Rugova, luftën e UÇK-së dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s. Partia ka deklaruar se aktgjykimi i sotëm nuk mund ta ndryshojë atë që e cilëson si të vërtetën historike të luftës në Kosovë.


"Asnjë aktgjykim, as ky i sotmi, nuk mund ta zhbëjë të vërtetën historike të luftës në Kosovë. Regjimi i Serbisë ushtroi gjenocid e krime kundër njerëzimit; zhvilloi një fushatë të egër terrori dhe spastrimi etnik në Kosovë; masakroi civilë të pafajshëm, vrau fëmijë, gra e të moshuar, ushtroi dhunë, dëboi me forcë popullsinë dhe dogji e shkatërroi fshatra e qytete të tëra", thuhet më tej.

Sipas LDK-së, këto krime kanë qenë sistematike dhe pasojat e tyre vazhdojnë të rëndojnë mbi familjet e Kosovës.

"Këto krime ishin sistematike, pasojat e të cilave rëndojnë edhe sot mbi mijëra familje. Përballë kësaj egërsie, populli i Kosovës luftoi për mbijetesë dhe liri", përfundon njoftimi./Dosja.al

9 MINUTA ME PARE

PAMJE/ Sërish tensione në Hagë, policia holandeze hedh ujë për të shpërndarë qytetarët



AKTUALITET 16 SHTATOR 2025, 12:40

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët" / Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

AKTUALITET 16 SHTATOR 2025, 12:09

"Nuk do të na thyejë" / Vajza e Jakup Krasniqi reagon pas dënimit me 25 vjet: Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

më të klikuarat



SKANDAL/ Deputetja Zegjine Çausi ishte në dijeni se daja i saj kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe

Rishfaqet "diMAL", pas mishit të infektuar, drogë në kontejner

"Paga bruto e një magjistari" / Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni kaq të madhe, është laps

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn/ Rama: Sërish Tirana pa kokë, askush nuk do t'ia dijë për koston e kryeqytetit

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

ME



Pamje

HAGA- Situata në Hagë është tensionuar sërish, ndërsa policia holandeze ka hedhur ujë në mënyrë që të shpërndajë turmën e protestuesve shqiptarë, të cilët ishin mbledhur jashtë ambienteve të Gjykatës Speciale për të pritur vendimin.

Pas hedhjes së ujit, disa qytetarë kanë hipur mbi automjetet e policisë duke i goditur ato. Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë është pritur me revoltë dhe pakënaqësi, pasi trupa gjykuese dënoi në total me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin./Dosja.al

9 MINUTA ME PARE

Avokati i Kadri Veselit: Do të reagojmë për të parë se cilat janë procedurat që duhet ndjekur



Rodni Dikson

HAGË- Avokati i Kadri Veselit Rodni Dikson ka deklaruar se mbrojtja do të reagojë pas vendimit të fundit, duke shqyrtuar procedurat që mund të ndërmerren më tej. Ai ka shprehur pakënaqësi me mënyrën se si është trajtuar çështja, duke vlerësuar se gjatë procesit ka pasur mungesë të dëshmive të mjaftueshme.

"Ka pasur mungesë të dëshmive dhe ne do të reagojmë për të parë se cilat janë procedurat që duhet ndjekur. Për fat të keq, kjo nuk është një ditë e mirë për Kosovën, për ligjin në përgjithësi", ka deklaruar avokati.

Ai shtoi se mbrojtja nuk është e kënaqur me mënyrën se si është zhvilluar procesi dhe me dëshmitë e paraqitura.

"Nuk jemi të kënaqur me krejt këtë mënyrë se si është trajtuar dhe me dëshmitë që janë paraqitur", u shpreh ai./Dosja.al

18 MINUTA ME PARE

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi





Pamje

HAGË- Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë, e cila dënoi në total me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, ka marrë jehonë ndërkombëtare. Reuters shkruan se ish-Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi u shpall fajtor për krime lufte, përfshirë vrasje, torturë dhe ndalim të paligjshëm nga gjykata e krimeve të luftës e Kosovës.

Thaçi u dënua me 25 vjet burg për krime të kryera si komandant i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë ndarjes së dhunshme të territorit nga Serbia në vitet 1990. Gjykata tha se ai ishte fajtor për vrasjen e 96 kundërshtarëve politikë dhe bashkëpunëtorëve të dyshuar me forcat serbe të sigurisë nga forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë konfliktit.

Reuters shkruan se vendimi u ndoq nga afër në Kosovë dhe Serbi, ku trashëgimia e konfliktit të viteve 1998-99 dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 mbeten një burim tensioni midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve. Në Prishtinë, mijëra njerëz që po e shikonin vendimin në një ekran të madh e fshkëllyen vendimin dhe brohoritën "Thaçi, Thaçi", ndërsa disa shpërthyen në lot.

"Ky vendim është i turpshëm. Nga sot, nuk do të ketë paqe në Kosovë", tha Raif Pllana, një ish-luftëtar i UÇK-së i cili doli në mbështetje të Thaçit në qendër të Prishtinës. Policia tha se ishin bërë përgatitje me forcat paqeruajtëse të huaja në rast se protestat do të bëheshin të dhunshme. Shtetet e Bashkuara i këshilluan qytetarët të shmangnin turmat.**Dosja.al**

24 MINUTA ME PARE

Organizata e Veteranëve të Luftës: UÇK s'ka qenë kurrë ndërmarrje kriminale



UÇK

KOSOVË- Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka thënë se UÇK-ja nuk ka qenë kurrë ndërmarrje kriminale tek e ka kundërshtuar dënimin e katër ish-udhëheqësve të UÇK-së nga Gjykata Speciale. Specialja me seli në Hagë dënoi të mërkurën Hashim Thaçin e Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 e Rexhep Selimin me 13.

Ata u dënuan për krime lufte, pasi Gjykata tha se kanë funksionuar si ndërmarrje e përbashkët kriminale.

"Hedhim poshtë kategorikisht dënimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ky aktgjykim godet luftën e drejtë çlirimtare të UÇK-së dhe lëndon çdo familje që dha bijtë dhe bijat për lirinë e Kosovës. UÇK-ja nuk ishte kurrë ndërmarrje kriminale. Ishte rezistenca e organizuar e një populli përballë pushtimit, dëbimit dhe masakrës, e vetmja përgjigje që i kishte mbetur një kombi të dënuar me zhdukje. Ajo sakrificë ndërtoi shtetësinë, sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të Kosovës. Asnjë institucion, kudo qoftë, nuk ka autoritetin moral ta nxjerrë në ajër këtë të

vërtetë. Asnjë vendim nuk mund ta rishkruajë luftën tonë çlirimtare apo të njollojë ata që luftuan për liri. E vërteta e UÇK-së nuk është çështje interpretimi gjyqësor, është historia e jetuar e një populli që e fitoi shtetin me gjak. Që në fillim e kemi quajtur politike këtë gjykatë dhe procesi na dha të drejtë. Është turp për drejtësinë ndërkombëtare, një njollë që do të mbetet gjatë dhe që tregon se si është trajtuar lufta jonë çlirimtare dhe sakrificat e popullit tonë”, thuhet në reagim të OVL-së./Dosja.al

32 MINUTA ME PARE

Albulena Haxhiu: Dënimet janë goditje e rëndë, fjala e fundit juridike nuk është thënë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.